

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari i vetëm Raman Asllani, në qështjen juridike civile të paditësit Ndërmarrja e Kosovës për distribuim dhe furnizim me energji elektrike SH. A. (KEDS) – Distribuimi në Prizren, të cilën e përfaqson i autorizuari B... P... , nga Prizreni, jurist i diplomuar i punësuar pranë paditësit, kundër të paditurit A... I... G... nga fshati B... , komuna e Prizrenit, për shkak të kompenzimit të dëmit, vlera e kontesti 591.46 €, pas përfundimit të shqyrimit kryesor publik në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit, më dt. 17. qershor 2015, muarrë këte:

A K T G J Y K I M


I. Aprovohet kërkesë padia e paditësit Ndërmarrja e Kosovës për distribuim dhe furnizim me energji elektrike SH. A. (KEDS) – Distribuimi në Prizren, andaj obligohet i padituri A... I... G... nga fshati B... , komuna e Prizrenit, që paditësit në emër të borgjit për energjinë e shpenzuar të i paguaj shumën prej 591.46 €, me kamatë ligjore për këte borgj e cila do të llogaritet nga dita e parashtimit të padis më dt. 19.03.2015, gjer në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcnim të ekzekutimit.

II. I padituri është i obliguar që paditësit të i paguaj shumën prej 30,00 € në emër të shpenzimeve të procedurës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi në padi kryesisht ka theksuar se i padituri më dt. 09.11.2011, me qëllim që vehtës të i sjell dobi të pasurisë së kundërligjshme në mënyrë të paligjshme ka çfrytëzuar energjinë elektrike, kështuqë në këte mënyrë i ka shkaktuar dëmë paditësit në shumën prej 591.46 €. Me aktgjykin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.462/12 i dt. 04.11.2013 i padituri është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 252. pika 1. të KPK dhe i është shqiptuar dënimini në të holla në shumën prej 150 €. Për realizimin e kërkesës pronësore juridike në shumën prej 591.46 €, e dëmtuara SH. A. (KEDS) – Distribuimi është udhëzuar në kontest civil.

I padituri në përgjegjen me shkrim në padi të dt. 16.04.2015 ka kontestuar theksimet në padi, obligimet e veta ndaj paditësit i ka përbushur rregullisht, konsideron se ai rrymën e hargjon shumë pak, sepse jeton me bashkëshorten, të cilët nga të ardhurat kanë vetëm pensionin e pleqërisë. Ka propozuar që kërkesë padia të refuzohet si e pabazuar.



Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më dt. 17.06.2015, i autorizuari i paditësit ka dekluaruar se në bazë të provave të shtjelluara padyshim është vërtetuar se i padituri është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në lartësi prej 591.46 €. Në procedurën penale është vërtetuar faji i i të paditurit, andaj vet deklaratat e të paditurit janë kundërthënëse me provattë cilat janë shtjelluar gjatë procedurës. Propozon që në bazë të gjendjes faktike të aprovohet kérkesë padia dhe i padituri të obligohet të paguaj shumën e cekur prej 591.46 €, me kamatë ligjore duke filluar nga dita e parashtrimit të padis si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës për taksën gjyqësore dhe për vendim të gjykatës.

Në shqyrtimin kryesor i padituri ka dekluaruar se konteston në tërësi kérkesë padinë dhe mbetet pranë theksimeve si në përgjegje të padis, propozon që e njajta të refuzohet si e pabazuar. Gjer më tanë të gjitha obligimet ndaj paditësit i ka përbushur rregullisht, do të thot, ka paguar për energjin elektrike të shpenzuar. Poashtu kérkesa e paditësit është e pabazuar për kompenzimin e taksës gjyqësore. Shton se nuk ka mundësi të kompenzoj dëmin edhe nëse gjykata aprovon kérkesë padinë, së cilës i kundërshton aprovimin.

Në procedurën e provave gjykata bëri shiqimin në: aktgjykimin e e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.462/12 i dt. 04.11.2013, faturën nr. DPZ11HP06550 e dt. 15.11.2011, vërtetimit numër 04/1049 i dt. 16.04.2015, tranksacioni i konsumatarit shifra numër 43505 e dt. 15.11.2011, proqesverbalit nr. 02 – 1249 – 6 i dt. 17.08.2011, proqesverbalit nr.1219339 shifra e konsumatorit 43505 e dt.02.11.2011, fotodokumentacionit me 6 foto.

Duke i vlerësuar këto prova në kuptim të nenit 8. të LPK , gjykata ka ardhur në përfundim se kérkesë padia eshtë e bazuar.

Në bazë të aktgjykit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.462/12 i dt. 11.12.2013, gjykata vërtetoi se i akuzuari A. G. nga fshati B., Komuna e Prizrenit u shpallë fajtor, sepse më dt. 13.08.2011, në banesën e të akuzuarit komisioni i autorizuar i KEK-ut – Distribuimi në Prizren pas kryerjes së kontrollës ka vërtetuar se i akuzuari me qëllim që vehtës të i sjellë dobi të pasurisë së kundërligjshme pa autorizim ka çfrytëzuar energjin elektrike në mënyrë që ka dëmtuar plombën shtetore , ka dëmtuar kapakun matësin e rrymës dhe nëpër vrimë ka penguar punën e diskut, kështuqë shpenzimi i energjis elektrike nuk ka mundur të regjistrohet në mënyrë të rregulltë, me këte ka dëmtuar KEK-un në shumë prej 591.46 € dhe në këte mënyrë ka kryer vepër penale të vjedhjes nga neni 252. pika 1. të KPK dhe është dënuar me dënim me burg me kusht në kohëzgjytje prej tre muajsh, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmëris së aktgjykit nuk kryen vepër penale të re. Më të njajtin aktgjykim i dëmtuarit KEK-Distribuimi në Prizren për realizimin e kérkesës pronësore juridike për shumën prej 591.46 € është udhëzuar në kontest civil.

Nga proqesverbalit i komisionit të autorizuar të KEK-ut – Distribuimi në Prizren nr.1219339 , shifra e konsumatorit 43505 e dt. 02.11.2011, gjykata vërtetoi se puntorët e KEK-ut me rastin e kryerjes së kontrollit zyrtar te konsumatori në bazë të kryerjes/së kalibrimit të matësit të rrymës më dt.

17.08.2011 me nr. 12496 dhe fotodokumentacionit është marrë efekti i instalimit, kurse i padituri nga aparatet për amvisni të cilët ishin të kyqur në rrjetin elektrik ka çfrytëzuar bojlerin në forcë prej 2000 W, shporetin prej 7500 W, makinën për larjen e petkave 3000 W, frigoriferin për ngrirje të thellë 800 W, thithsen prej 1200 W, hekurin prej 1200 W, TV 150 W, 5 copa poça të forcës nga 100 W, nxemsën prej 3000 W.

Nga fatura DPZ11HP06550 e dt. 15.11.2011, gjykata vërtetoi se shuma e përgjithshme e dëmit për shkak të çfrytëzimit të paautorizuar të energjis elektrike, ka shumën prej 591.46 €.

Me shtjellimin e provave në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i padituri në mënyrë të paligjshme ka çfrytëzuar energjin elektrike, fakt i cili është vërtetuar në procedurën penale, që paraqet bazën e përgjegjësisë dhe në këte mënyrë paditësit i ka shkaktuar dëmin në shumën e përgjithshme prej 591.46 €, dëmi i cili është llogaritur sipas ekspertizës së komisionit të paditësit. Në rastin konkret gjykata ka pranuar lartësinë e vërtetuar të dëmit nga ana e paditësit, që ishte bazë për vërtetimin e përgjegjësisë penale, kurse vërtetimi i lartësisë së dëmit në këte procedurë do të shkaktonte shpenzimet disproporcionale përmes ekspertizës, andaj gjykata pranoi lartësinë e të njajtit siq ka vendosur paditësi.

Sipas nenit 154. par. 1. të Ligjit mbi marrëdhënjet detyrimore, kur dikush dikujt i shkakton dëmë, është i obliguar që dëmin të kompenzoj, nëse nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.

Pashtu sipas nenit 277. par. 1. të të njatit ligj debitori i cili vonohet në përbushjen e obligimit në të holla ka borgjë përveq kryegjës (borgjat kryesor) edhe kamatën e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padis.

Shpenzimet e procedurës janë caktuar sipas nenit 452. al. 1. të LPK, sepse pala e cila në tërësi e humb kontestin është e obliguar që palës së kundërt të tia kompenzoj shpenzimet e procedurës, ku janë llogaritur shpenzimet në emër të pagesës së taksës gjyqësore dhe vendimit gjyqësor.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, më dt. 17. qershori 2015

C.nr. 299/15



Përkthyesi

Sedat Gashi

UDHËZIME JURIDIKE:

Gjyqtari

Raman Asllani, d.v

- Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes të njajtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.